

# QENDRA PËR ONKOLOGJI DHE RADIOTERAPI



ACIBADEM



ACIBADEM  
SISTINA

← EXIT

PET CENTER



6

PTA





T-Mobile



## ACIBADEM SISTINA QENDËR PËR ONKOLOGJI DHE RADIOTERAPI

Qendra për onkologji dhe radioterapi bën të mundur trajtimin e sëmundjeve malinje sipas standardeve botërore, me staf profesional dhe teknologji të përparuar. Sëmundjet malinje kërkojnë një proces trajtimit të veçantë dhe të ndërlikuar, për këtë arsyе është tepër i rëndësishëm procesi i integruar i cili ofron efikasitet dhe kujdes më të mirë për pacientët. Prandaj kemi krijuar qendrën në të cilën ofrohen të gjitha shërbimet për diagnostikimin dhe trajtimin në një vend të vetëm, e thënë ndryshe „nën një çati“, të cilës i kemi dhënë një theks të veçantë komoditetit dhe rehatisë së pacientëve. Sëmundjet malinje janë në rritje të vazduar në mbarë botën. Me anë të diagnozës së hershme, kjo sëmundje mund të shërohet. Sot, me zhvillimin e teknologjisë dhe mjekësisë moderne, shumë pacientë diagnostikohen në fazën e fillimit të sëmundjes, dhe me ndihmën e protokolleve bashkëkohore të trajtimit, sëmundja mund të shërohet. Duke u nisur nga kjo, kemi investuar në teknologjinë më të fundit për gjetjen e diagnozës dhe trajtimin e saj, si dhe vazhdimisht i ndjekim dhe i implementojmë terapitë dhe protokollet më të fundit për trajtim. Qendra për onkologji dhe radioterapi ofron kimioterapi, radioterapi dhe kirurgji onkologjike në një vend të vetëm, me një ekip specialistësh me përvojë shumëvjeçare. Gjithashtu, spitali ynë i'u ofron pacientëve me sëmundje malinje përdorimin e procedurave diagnostikuese më bashkëkohore duke përfshirë këtu edhe ekzaminimin PET/CT.

## KOMODITETI I PACIENTËVE ËSHTË PRIORITETI YNË

Dizajni modern dhe dhomat e specializuara ofrojnë rehati dhe komoditet për pacientët dhe familjarët e tyre. Qendra për onkologji dhe radioterapi ka 12 hapësira dhe një dhomë izolimi për radioterapi me jodio. Çdo ambient është i dizajnuar në mënyrë që të ruaj privatësinë dhe ti ofroj komoditet pacientit. Ambientet janë të pajisura me televizor dhe internet.



## METODA MULTIDIPLINARE

Në qendrën për okologji dhe radioterapi, funksionon këshilli onkologjik i mjekëve të specializuar në fusha të ndryshme, të cilët punojnë së bashku në mënyrë që të ofrojnë mundësi më të mira në trajtimin e pacientëve.

Protokollet për trajtimin e çdo pacienti me kancer në Acibadem Sistina, janë të miratuara nga ekip specialistësh me përvojë. Trajtimi planifikohet, ndërkohë që pacienti është nën vëzhgim përgjatë gjithë procesit të trajtimit. Në të njejtën kohë, i kushtohet vëmendje edhe reduktimit të efekteve anësore të shkaktuara nga terapia, rritjes së nivelit të energjisë dhe fuqisë së pacientit në mënyrë që ta kalojë më lehtë procesin e trajtimit.





## SHËRBIMET QË OFRON QENDRA

### Kirurgjia onkologjike

Kirurgjia luan një rol tepër të rëndësishëm në diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit. Ndërhyrjet kirurgjikale onkologjike, kryhen nga ana e kirurgëve të specializuar në fusha të ndryshme të kirurgjisë: abdominale, torakale, urologjike, ortopedike dhe traumatologjike, neurologjike, plastike, gjinekologjike dhe ORL.

## Onkologjia Mjekësore


Çdo fazë e sëmundjeve malinje është subjekt i onkologjisë mjekësore. Trajtimi i patientëve planifikohet në mënyrë multidisiplinare dhe bazohet në dëshmitë bazë të mjekësisë. Trajtimi onkologjik i kryer në Qendrën për onkologji dhe radioterapi nga ana e ekipit tonë të profesionistëve, nënkupton aplikimin e ilaçeve intravenoze apo orale. Këtu përfshihet: kimioterapia, terapia hormonale, imunoterapia dhe trajtimi biologjik.


- **Kimioterapia:** këtu aplikohen ilaçet që përdoren me qëllim për të shkatërruar qelizat kancerogjene, gjatë të cilave shpesh kombinohen preparate citostatike me mekanizëm të ndryshëm veprimi. Në spitalin Acibadem Sistina, ekipi i onkologëve i ndjek vazhdimesh arritjet e fundit në onkologji si dhe efektivitetin e tyre në përputhje me standartet e pranuara.

- **Terapia hormonale:** rekomandohet për trajtimin e tumoreve tek të cilat ekziston varësia hormonale, si kanceri i prostatës dhe kanceri i gjirit. Numri më i madh i preparateve aplikohet në mënyrë orale, por ekziston dhe mundësia e aplikimit në muskul të disa preparateve të caktuara të këtij grupei.

- **Imunoterapia:** ka të bëjë me përdorimin e substancave të cilat sistemi imunitar i prodhon në mënyrë natyrale dhe përdoren për ti identifikuar dhe shkatërruar qelizat kancerogjene me anë të aktivizimit të sistemit imunitar.

**Terapia biologjike:** një nga zbulimet më të rëndësishme në dekadën e fundit në onkologji, janë preparatet biologjike me efekt të lartë dhe me pak efekte anësore, të cilat ndikojnë tek receptorët e duhur të cilat gjenden tek qelizat e tumorit, por që nuk gjenden tek qelizat normale. Kjo metodë moderne e terapisë onkologjike, përdoret përkatesisht tek llojet e ndryshme të kancerit, veçanërisht tek kanceri i gjirit, zorrës së trashë dhe kancerit të veshkave.





## Radioterapi

Në këtë segment të qendrës për onkologji dhe radioterapi, janë të mundshme dy lloje të trajtimit: radioterapia dhe radiokirurgjia.

Teknologja e përparuar që përdorim në radioterapi, mundëson shkatërrimin e indit të kancerizuar me doza të larta të rrezatimit dhe në të njëjtën kohë i mbron indet e shëndetshme.

Radiokirurgjia është pjesë e radioterapisë me anë të së cilës trajtohen tumoret, zakonisht ato tumore të trurit të cilat nuk mund të trajtohen me anë të kirurgjisë. Për herë të parë në rajon, ky lloj i terapisë rrezatuese gjendet në Acibadem Sistina, me ndihmën e përshtapjesit më të sigurt dhe më të fuqishëm TRILOGY.

## Mjekësia nukleare dhe PET/CT

Në fushën e mjekësisë nukleare janë të disponueshme shërbimet për diagnozën dhe trajtimin e kancerit, të pajisura me PET/CT dhe kamera gama. Disponon apartament me një shrat të vetëm për trajtimin e pacientëve me izotope radioaktive, të projektuar posaçërisht për mbrojtje maksimale të pacientëve, stafit dhe përreth. Këtu aplikohet edhe radioterapia me jodio për pacientët me tregues të përshtatshëm, si dhe terapia palliative për dhimbjet metastatike të kockave.

## DIAGNOZË DHE TRAJTIM ME TEKNOLOGJI MODERNE

Qendra për onkologji dhe radioterapi në „Acibadem Sistina“ mundëson diagnozë dhe trajtim me teknologjinë më bashkëkohore dhe infrastrukturë sipas standardeve botërore.

### Teknologjite për diagnozë

**MRI (3 Tesla)\*:** përdoret për të arritur fotografime të shpejta dhe cilësore të gjithë trupit. Me ndihmën e MRI arrihet pasqyrimi i qartë i indeve të buta, nëpërmjet një numri të madh fotografimesh në shumë kënde. Përdoret për diagnozën e tumorit në tru, tumorit të kockave, sarkomat e indeve të buta dhe tumoret e palcës kurrizore.

**PET/CT:** është teknika më efikase e filmimit e cila përdoret për vendosjen e diagnozës, për përcaktimin e fazës së sëmundjes, për përcaktimin e efektit terapisë për kancer, kjo ndihmon edhe për planifikimin e kimioterapisë apo radioterapisë në shumicën e rasteve të kancerit. Vetëm me anë të një filmimi përcaktohet vendndodhja e saktë e kancerit, gjithashtu përcakton edhe përhapjen e kancerit.

**CT (128 slice):** me ndihmën e rrezeve X, arrihet pamja e brendshme e trupit. Kjo teknologji përdoret për vizualizimin e indeve të buta, kockave dhe organeve.

**Kamera gama SPECT:** kamera SPECT me dy detektues e cila përdoret për shumë qëllime, mundëson kryerjen e një game të gjërë të shqyrtimeve të diagnozës mjekësore nukleare.

\* nga muaji nëntor 2016

## Teknologjia që përdoret për trajtim

**TRILOGY:** përshtpejtuesi linear më i saktë në radiologji për trajtimin e tumoreve, me një vëllim të vogël që në të njejtën kohë mundësin mbrojtje maksimale të indeve të shëndetshme përreth. Përdoret për një trajtim të suksesshëm të të gjitha tumoreve, si dhe të disa sëmundjeve të caktuara hematologjike siç janë limfomat. Veçanërisht është i suksesshëm në trajtimin e kancerit në mushkëri, kancerit të mëlçisë dhe kancerit të gjirit, ku është i nevojshëm monitorimi respirativ. Gjatë trajtimit, TRILOGY mund ta ndyshojë pozicionin dhe ta rrezatojë kancerin në më shumë kënde. Me ndryshimin e këndit rrezatimi mbulon tërësisht pjesën e synuar duke mbrojtur indet e shëndetshme përreth. Në këtë mënyrë rritet suksesi i trajtimit. Teknologjitetë cilat përdoren në këtë aparat janë:

**IMRT (radioterapia me intensitet të moduluar):** - rezulton me shpërndarjen e dozës së lartë të rrezatimit të cilin duhet të marrë tumorri, dozë e cila është e përshtatshme maksimalisht për të, madje edhe kur forma e tij është komplekse dhe e pasaktë. Me ndihmën e kësaj tekniqe të rrezatimit, vendoset doza e dëshiruar në tumor, me një mbrojtje maksimale të organeve të shëndetshme.

**IGRT (radioterapia e drejtuar nga imazhet):** - mundëson përcaktimin dhe lokalizimin e tumorit gjatë kryerjes së trajtimit. Falë kontrolleve të përditshme me imazhe (fotografim) mund të vërehet nëse tumorri të cilin duhet ta rrezatojmë, ndodhet në fushën e rrezatimit. Pacienti fotografohet jo vetëm para terapisë, por, edhe gjatë saj, duke mundësuar në këtë mënyrë parandalimin e mundshëm të spostimit të tumorit gjatë periudhës së filmimit.

**SRS (radiokirurgja stereotaktike):** - ka për qëllim që ta drejtojë dozën e rrezatimit në mënyrë të saktë dhe precise drejt zonave të synuara. SRS përdoret për rrezatimin e zonës në të cilën gjendet tumorri. Kjo terapi rrezatuese mund të përdoret edhe për trajtimin e tumoreve në ato pjesë të trurit të cilat nuk mund të operohen.

## BESOJMË DHE LUFTOJMË SË BASHKU

### Spitali më i mirë me stafin më të mirë

Nuk e dija që në Shkup ekzistonte një spital kaq i madh dhe me kaq shumë mundësi teknike dhe njerëzore, përndryshe do të kisha ardhur më parë këtu. Thjesht jam e mahnitur nga kapaciteti, aparatet dhe humanizmit. Ky spital nuk është vetëm qendra më e madhe në ballkan, por ky spital është shumë më i mirë dhe më modern në krahasim me shumë klinika të tjera evropiane. Ajo çfarë është më e rëndësishme, është se falë aparatit PET/KT, këtu ofrohet marrja e diagnozës më të saktë, dhe për të mos folur më pas për kushtet e marrjes së terapisë të cilat janë në nivelin botëror. Përgatitja për marrjen e terapisë është e pabesueshme, dhe pacienti nuk ka efekte anësore, diçka tepër e rëndësishme është se gjithçka kryhet në një vend, si dhe mund të kombinohet kimioterapia, terapia biologjike dhe imunoterapia. Por sigurisht, gjëja më e rëndësishme është se në spitalin klinik "Acibadem Sistina" gjenden mjekët më të mirë. Pas Zvicrës, Floridës, Parisit, Indisë, Londrës, unë këtu jam në duart më të sigurta, gjithçka tjetër varet nga planet që ka Zoti me mua. Kur njeriu vuan nga një sëmundje e tillë, është shumë i rëndësishëm raporti i mjekëve dhe ekipit mjekësor. Këtu, në "Acibadem Sistina", me të vërtetë në çdo hap gjeni buzëqeshje, mbështetje dhe mirëkuptim, por edhe kohë për veten. Nuk e di si janë zgjedhur këta njerëz këtu, që të gjithë të janë të këndshëm dhe të ndjeshëm, këtë nuk e kam hasur asgjékundi. Gjatë qëndrimit në spital, për mua ka shumë e rëndësi privatësia dhe mirëkuptimi, pasi nëse profesionalizmi nuk është i shoqëruar me humanizëm, pacienti ndjehet keq. Është e pabesueshme që ky spital ka 1000 të punësuar dhe çdo punonjës me të cilin kam pasur kontakt ka qenë i përzemërt, i këndshëm, i ndjeshëm dhe nuk ekziston arroganca dhe ftohtësia mjekësore. Për shembull, më ndodhi në Paris, Zvicër, madje edhe në Serbi, që mjekët të sillen si perëndi të cilët nuk sëmuren. Këtu nuk është rasti i tillë, këtu humanizmi dhe mirëkuptimi janë shenja identifikuuese për këtë spital. Unë jam shkrimitare dhe jam shumë e ndjeshme, për mua është shumë e rëndësishme mënyra se si dikush më thotë mirëmëngjes, dhe mënyra se si më shikon gjatë marrjes së terapisë si dhe nëse për mjekun jam vetëm diagnozë apo qenie njerëzore.

Isidora Bjelica

ACI BADEM

SISTINA





## **Prof. Jovica Ugrinovski ka një vend të veçantë në zemrën dhe shpirtin tim**

24 dhjetori I vitit 2014 ishte dita më e keqe dhe më e dhimbshme në familjen time. Biri im David, si pasojë e tumorit në kokë, në orën 03:30 përjetoi një sulm dhe fillova të ndjeja se po e humbisja në krahët e mi. Falë Zotit, që pikërisht në atë moment e dërgoi infermjerën Kristina në dhomën tonë, dhe menjëherë e dërguan Davidin në sallë. Prof. Jovica Ugrinovski, pothuajse për 20 minuta mbërriti në spitalin klinik “Acibadem Sistina” dhe menjëherë filloi të luftonte për jetën e birit tim Davidit. Operacioni zgjati disa orë. Falë profesionalizmit dhe besimit të Prof. Ugrinovskit, Davidi sot ndodhet midis nesh. Ai së bashku me bekimin e Perëndisë e shpëtoi birin tim dhe i dha edhe një mundësi tjetër për të jetuar. Nuk gjej dot fjalë për të shprehur domethënien që ka ky njeri në jetën time dhe në jetën e familjes time. Ai është shpëtimtari ynë. Jo vetëm që shpëtoi Davidin, por na shpëtoi edhe ne. Prof. Ugrinovski, urojmë të keni jetë të gjatë dhe plot shëndet, Zoti qoftë gjithmonë me ju dhe me të afërmit tuaj. Ju keni një vend të veçantë në zemrën dhe shpirtin tim, dhe do t'ju jem mirënjojëse përjetë sepse ju e shpëtuat birin tim Davidin. Gjithmonë do t'ju detyrohem juve, menaxherëve dhe stafit mjekësor të “Acibadem Sistina” për gjithçka që kanë bërë për ne. Davidi ishte vërtetë i preferuari i tyre dhe asnijëherë nuk lejuan që t'i mungonte asgjë. Spitali na ofroi kushtet më të mira për trajtimin e tij, gjithashtu, edhe ne morëm një strehim të veçantë në spital për të qenë vazhdimisht pranë tij.

*Ana Domazetovska*



# ACIBADEM | SISTINA

Skupi 5A, 1000 Shkup, Maqedoni

call center  
(( 02 3099 500 ))  
[www.acibademsistina.mk](http://www.acibademsistina.mk)